

Zyrës së doktoratave të Universitetit të Tetovës  
Këshilli mësitor-shkencor i Fakultetit juridik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësitor-shkencor i Fakultetit juridik i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 24.06.2021, solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull “**Gjenocidi në Kosovë gjatë luftës 1998-1999**”, të kandidatit Mr. sc. Artan Tahiri.

Në bazë të vendimit nr. 13-499/2, të datës 24.06.2021, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Afrim Osmani (kryetar), Prof. Dr. Fatbardha Ismaili (anëtar), Prof. Dr. Afet Mamuti (anëtar), Prof. Dr. Shefik Shehu, (anëtarë) dhe Prof. Dr. Qebir Avziu (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësitor-shkencor të Fakultetit juridik i paraqet këtë

## **R A P O R T**

### **për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës**

#### **Të dhënat biografike të kandidatit:**

Mr. sc. Artan Tahiri është i lindur, më 17 korrik 1980, në Dragash. Shkollën fillore e mbaroi në fshatin Brrut, komuna e Dragashit, si dhe në Heidenheim an der Brenz - Gjermani, ndërsa atë të mesme në Heidenheim an der Brenz – Gjermani dhe në Dragash. Studimet bachelor dhe master i ka mbaruar në Universitetin e Prishtinës.

Në vitin 2006-2010 ka punuar si Sekretar në Kolegjin Universum, si dhe Imësimdhënës në Kolegjin e Mesëm Universum, po ashtu ka mbajtur ushtrimet në disa lëndë në arsimin e Lartë të Kolegjit Universum. Gjatë kësaj periudhe ka qenë anëtar i Këshillit të përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nga viti 2012 është caktuar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit UBT, si dhe njëkohësisht ka ligjëruar lëndët Etika ligjore dhe të drejtat e njeriut, E drejta kushtetuese, E drejta kushtetuese e krahasuar, E drejta administrative, E drejta e procedurës administrative në kuadër të Fakultetit Juridik, gjersa në Fakultetin Shkenca Politike ka ligjëruar lëndën E drejta administrative, si dhe në Fakultetin Media dhe Komunikim ka ligjëruar lëndën E drejta dhe Poltikbërja.

Deri më tani, Mr. sc. Artan Tahiri ka botuar këto punim shkencore:

- PHILOSOPHICA, International Journal of Social and Human Sciences, ISSN: 1857-9272 (Print), ISSN: 2671-3020 (Online), [Google Scholar](#), [IndexCopernicus International](#), [CEEOLAcademic Search Complete \(EBSCO\)](#) - *under indexing phase*
- JUSTICIA, International Journal of Legal Sciences, ISSN: 1857-8454 (Print), ISSN: 2545-4927 (Online), UDC: 34, [Google Scholar](#), [IndexCopernicus International](#), [CEEOLAcademic Search Complete \(EBSCO\)](#) - *under indexing phase*

#### **Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës:**

Kandidati Artan Tahiri që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë e deri më sot ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të temës. Ai me sukses ka realizuar tre konferencat doktrate, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar disa artikuj shkencor.

#### **Analizë e punimit: “Gjenocidi në Kosovë gjatë luftës 1998-1999”**

Në disertacionin e tij të doktoratës me titull **“Gjenocidi në Kosovë gjatë luftës 1998-1999”**, trajton gjenocidin e ushtruar nga ana e shtetit të Serbisë ndaj popullatës civile.

Përmes këtij punimi të doktoratës kandidati ka paraqitur dëshmi dhe fakte të cilat deri më tani nuk janë trajtuar, të cilat dëshmojnë se në Kosovë është kryer gjenocid nga ana e forcave serbe, si dhe procedurën të cilën Kosova duhet të ndjekë për njohjen e gjenocidit nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë duke i marr rastet krahasimi me vendet të cilit kanë iniciuar procedurën e njohjes së gjenocidit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Në punimin e tij, kandidati është përpjekur të trajtoj dhe paraqet arsyet dhe ligjshmërinë përmes të cilave shteti serb do të merrte përgjegjësin dhe do të ndëshkohet në përputhje me Konventën për

Parandalimin dhe ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit si dhe do të ketë si rrjedhojë dëmshpërblimin moral dhe material të viktimave të gjenocidit.

Mr. sc. Artan Tahiri është përpjekur të bëjë analizë sintetike dhe të thelluar të çështjes së luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, ku ka pasur si pasojë një numër të madh viktimash, sidomos në mesin e popullsisë civile.

Kandidati ka paraqitur dhe ofruar dëshmi që gjatë luftës në Kosovë janë vrarë, por edhe masakruar nga trupat paramilitare, por dhe ato të rregullta të ushtrisë serbe të cilat janë në kundërshtim flagrant me të drejtën ndërkombëtare dhe parimet themelore të së drejtës humanitare dhe të drejtën e luftës në përgjithësi.

Kandidati ka paraqitur se idetë për gjenocid ndajë popullatës shqiptare të Kosovës, janë paraqitur qartazi në programet dhe strategjitë serbe, qysh nga viti 1844 dhe ato janë vazhduar deri në vitin 1999.

Kandidati ka paraqitur argumente të vazhdimësisë së represionit serb, e cili si tendencë kishte shfarosjen e popullatës shqiptare me ç ‘rast forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe të udhëhequr nga organet qeveritare në Serbi, ndërmorën një ofensivë ndaj popullit shqiptar në Kosovë në vitin 1998 dhe 1999, ku si pasojë shkaktojë dëbimin e mbi 800 mijë shqiptarëve nga shtëpitë e tyre dhe vrasjen dhe masakrimin e mbi 15 000 mijë civileve.

Kandidati ka paraqitur dëshmi që njësitë militare dhe paramilitare të ushtrisë serbe gjatë kësaj periudhe kohore shkatërruan dhe dogjën mbi 1.000 vendbanime shqiptare, plaçkitën, djegën dhe shkatërruar mbi 200 mijë shtëpi, banesa, lokale, biznese, punishte zejtarie, fabrika, shkolla, biblioteka, monumente kulturore-historike, objekte kulturore, shkencore, fetare etj.

Tema është ndërtuar nga Hyrja, katër kapituj, Përfundimi dhe Bibliografia.

**Kapitulli i parë**, i cili përfaqëson boshtin e këtij studimi monografik, përfshin shqyrtimin teorik të gjenocidit. Aty janë trajtuar aspektet historike të paraqitjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të drejtën ndërkombëtare, me koncentrim në gjenocid.

Kandidati këtë pjesë e ka ndarë në dy nënkapituj, dhe atë në fazën para miratimit të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimin të Gjenocidit dhe fazat e miratimit të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimin të Gjenocidit. Në fazën e parë, kandidati ka paraqitur rastet të cilat janë trajtuar dhe si janë rregulluar përmes marrëveshjeve ndërmjet shteteve, e deri te trajtimi i saj në të drejtën ndërkombëtare. Në veçanti i është kushtuar akteve juridike të miratuara në nivel të shtetit dhe të cilat kanë pasur ndikim në zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kandidati në kuadër të këtij kapitulli ka paraqitur mënyrën e trajtimit të rasteve në Gjykatën Ushtarake Ndërkombëtare të Nurenbergut dhe Gjykatën Ushtarake Ndërkombëtare të Tokios.

Kandidati ka paraqitur veprimet e ndërmarra në kuadër të Kombeve të Bashkuara me qëllim të kodifikimit në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, ndëshkimin e krimin të gjenocidit, sidomos mekanizmat të cilat janë krijuar dhe grupet punuese në drejtim të kodifikimit.

Kandidati ka paraqitur një përmbajtje thelbësore të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimin të Gjenocidit, si dhe instrumentet e hyrjes në fuqi të saj. Në veçanti i është kushtuar elementeve të cilat përcaktojnë krimin e gjenocidit dhe përgjegjësit ndaj atyre të cilit me veprimet e tyre kanë shkaktuar gjenocid.

Në kuadër të këtij kapitulli kandidati ka paraqitur të dhënat dhe dëshmitë për kryerjen e organizuar të veprimeve nga ana e shtetit serb në Kosovë, me koncentrim programeve dhe strategjive të qarqeve serbe të cilat kanë gjetur implementim përmes forcave ushtarake dhe atyre vendimmarrëse dhe të cilat kanë qenë të drejtuar ndajë popullatës shqiptare. Paraqitja kronologjike e mënyrës së ushtrimit të gjenocidit ndaj shqiptareve nga ana e forcave serbe, si dhe dëmeve të shkaktuara në popullatë, por edhe dëmeve ekonomike të cilat e kanë vendosur popullatën shqiptare në kushte të atilla e cila ka ndikuar në ekzistencën e saj.

Kandidati ka paraqitur të dhënat dhe dëshmitë për dëbimin e mbi një milion shqiptareve nga vendbanimet e tyre gjatë periudhës 1998-1999. Dëbim i cili është shoqëruar me vrasjen e civileve, dhunim dhe grabitje të pasurisë së tyre, kërcënimin të vazhduar për eliminimin fizik, si dhe vendosja në hapësira të cilat kanë ndikuar cenimin e jetës së tyre. Kjo është e realizuar përmes

një planifikimi të mirëfilltë dhe mirë të koordinuar dhe kontrolluar nga ana e Qeverisë së Serbisë. Në këtë rast ka paraqitur të dhënat e dëbimit të popullsisë civile shqiptare brenda territorit të Kosovës, por edhe ato drejtë vendeve fqinjë dhe atyre të Evropës Perëndimore.

Kandidati ka paraqitur të dhënat dhe dëshmitë e masakrave të forcave serbe mbi popullatën civile në të cilat ka paraqitur se si forcat ushtarake, paramilitare dhe policore serbe kanë vrar, masakruar dhe djegur popullsinë civile shqiptare. Veprimet të cilat janë ndërmarr nga ana e forcave serbe me qëllim të fshehjes dhe zhdukjes së gjurmëve dhe se si një aparat i tërë është angazhuar në realizimin e saj. Masakrimi i popullatës civile nuk ka njohur dallim në moshë, gjini, por vetëm një emërues të përbashkët.

Kandidati ka paraqitur të dhënat dhe dëshmitë për asgjësimin e pasurisë nga ana e ushtrisë serbe në Kosovë. Popullsia civile shqiptare, jo vetëm që nuk u kursye nga vrasja, spastrimi etnik, dhunimet e popullsisë civile shqiptare, por i është shkatërruar e gjithë pasurin e ndërtuar nga ana e tyre. Në disa raste forcat serbe në mënyrë sistematike kushtëzonin shqiptarët që për t'u kursyer jetën e tyre të kompensojnë me vlerë monetare. Kandidati ka paraqitur dëmet e shkatuar në shtëpi, shkolla, zyra të vendit, shtëpi kulture, biblioteka publike dhe private, objekte shëndetësore, objekte fetare, si dhe objekte ndihmëse në tërë territorin e Kosovës.

Kandidat ka paraqitur të dhënat dhe dëshmitë për asgjësimin civilëve pa gjyqe të luftës. Veprimet e ushtrisë dhe forcave paramilitare në tërë territorin e Kosovës gjatë luftës 1998-1999 si dhe me qëllim të realizimit të operacionit të spastrimit etnik të Kosovës nga shqiptarët, përdoren metoda të cilat futen friken tek civilët, por ata pa kurrfarë paralajmërimi dhe vendimi të organeve gjyqësore eliminuan civilët. Këto janë kryer me dijen e komandanteve të cilit kanë qenë përgjegjës për ato territore dhe nuk kanë ndërmarr veprime për parandalimin e tyre.

**Kapitulli i dytë** bën fjalë për metodologjinë e përdorur në realizimin e punimit të doktoratës në të cilën janë përdorur metodat kualitative dhe ato kuantitative. Në kuadër të këtij kapitulli kandidati ka paraqitur analizimin e të dhënave tematike, teknikat dhe instrumentet, objektin e hulumtimit dhe hipotezat e ngritura.

Kandidati për realizimin e këtij disertacioni ka dy qasje metodologjike që janë përdorur: intervista e thellë gjysmë e strukturuar si dhe anketa përmes pyetësorëve. Kandidati përmes këtyre metodave ka siguruar që të dhënat e mbledhura dhe për t'iu përgjigjur një grupi pyetjesh kërkimore të hulumtimit të verifikoj vlefshmërinë e të dhënave dhe gjetjeve të kërkimit duke i bërë këto të fundit

më relevante dhe më të besueshme gjithashtu. Pikërisht për këtë është përdorur Intervista si pjesë e metodave kualitative e cila ka kompenuar mangësitë dhe boshllëqet eventuale që konsiderohet që do të krijohen nga përdorimi i anketës (përmes pyetësorëve), si pjesë e metodave cilësore, gjersa intervistat gjysmë strukturuara si pjesë e metodës kuantitative janë realizuar në ambientet në të cilat i kanë përcaktuar palët e intervistuar si në objektet e institucioneve në të cilët këta janë të angazhuar, por në disa raste edhe në ambiente të hapura dhe në vendbanimet e të intervistuarve. Kandidati ka realizuar 10 intervista të thellë gjysmë të strukturuara me aktorë relevant në Kosovë nga institucione të ndryshme relevante si:

- Institucione shtetërore (Instituti i Mjekësisë Ligjore të Kosovës);
- Akademia (studiues të së drejtës ndërkombëtare publike dhe të drejtës ndërkombëtare penale);
- Familjarë të viktimave;
- Përfaqësues nga OJQ të ndryshme që merren me këtë fushë.

Kandidati në kuadër të hulumtimit empirik, ka realizuar gjithsej 262 pyetësor me qytetarët e Kosovës. Participantët janë zgjedhur sipas parimit rastësor dhe të gjithë janë anonim. Anketa është e ndarë në dy pjesë, ku në pjesën e parë do të marrim informata të përgjithshme demografike, ndërsa në pjesën e dytë është koncentruar në pyetje lidhur me qëndrimet dhe perceptimet e të anketuarve lidhur me ndodhitë e luftës së Kosovës në vitet 1998-1999 që ndërlidhen me gjenocidin në Kosovë.

**Kapitulli i tretë** kandidati pjesë të disertacionit ka paraqitur gjetjet dhe faktet të cilat kanë dalë si rezultat nga aplikimi i dy metodave hulumtuese: anketës dhe intervistës gjysmë të strukturuar. Këto të dhëna kandidati i ka paraqitur sipas nevojës: në tabela, grafike, në mënyrë që të krijohet një pasqyrë e përgjithshme dhe e detajuar për rezultatet e fituara nga hulumtimi.

Për t'i analizuar këto të dhëna, kandidati ka përdorur metoda analitike statistikore deskriptive dhe konkluduese. Kandidati këto analiza i ka paraqitur duke përdorur programin SPSS program për analizimin e të dhënave e të dhënave sasiore, kjo në mënyrë që analizimi i variabla të bëhet në mënyrë adekuate.

Në kuadër të këtij kapitulli kandidati ka vërtetuar hipotezat e ngritura në bazë të hulumtimit të realizuar dhe të gjetura nga ky hulumtim në të cilën ka paraqitur dëshmitë dhe faktet për konfirmimin e shtatë hipotezave të ngritura. Në këtë rast kandidati ka konfirmuar se:

- Ekziston kryerja e organizuar e gjenocidit nga ana e shtetit serb në Kosovë;
- Ekziston propagandimi shtetëror për asgjësim të shqiptarëve të Kosovës;
- Ekziston dëbimi i mbi një milion shqiptarëve nga vendbanimet e tyre;
- Ekzistojnë masakrat e forcave serbe mbi popullatën civile;
- Ekziston asgjësimi i pasurisë dhe dokumentacionit;
- Ekziston asgjësimi i civile pa gjyqe të luftës;
- “Plani Patkoi” i Akademisë së Serbisë që vërteton për një planifikim gjenocidi

**Kapitulli i katërt, kandidati ka realizuar** interpretimin e rezultateve në formë të detajuar dhe të gjitha gjetjet e dala nga të dy metodat e aplikuara.

Kjo është një ndër pjesët më të rëndësishme të disertacionit. Këtu është realizuar interpretimi i rezultateve në formë të detajuar dhe të gjitha gjetjet e dala nga të dy metodat e aplikuara.

Është tejet me rëndësi që të theksohet fakti se këto gjetje dhe rezultate shkencore nuk janë prezantuar vetëm në mënyrë deskriptive, por ato janë krahasuar edhe më rezultate të dala nga studime të ngjashme në botë.

Ndër shtetet të cilat janë marr si shembuj krahasuese dhe të cilat janë trajtuar, janë Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroacia.

Ky krahasim i ka shërbyer kandidatit për konstatimin e relevancës së rezultateve të hulumtimit, krahasueshmëria krijon një standard relevant të cilësisë së rezultateve dhe gjithashtu kredibiliteti dhe besueshmëria janë në një nivel më të lartë dhe solid gjithashtu.

### **Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:**

Gjatë hartimit të këtij punimi doktrate, me titull “**Gjenocidi në Kosovë gjatë luftës 1998-1999**” kandidati i është përmbajtur respektimit të standardeve metodologjike në punën kërkimore-shkencore. Janë shfrytëzuar disa metoda shkencore, si ajo: e analizës, historike, krahasuese, empirike, e intervistimit, etj. pasi tema është e kufizuar në periudhë kohore (1998-1999) dhe një hapësirë të caktuar gjeografike, ndarja e saj është bërë mbi bazë tematike.

Për përgatitjen e temës, kandidati ka shfrytëzuar literaturë të pasur, artikuj shkencor, materiale nga interneti etj.

### **Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:**

Tema e doktoratës “**Gjenocidi në Kosovë gjatë luftës 1998-1999**”, përbën një përpjekje nga ana e kandidatit për të argumentuar ekzistencën e gjenocidit të kryer nga ana e shtetit serb në Kosovë gjatë luftës 1998-1999.

Me punën e tij, kandidati ka arritur që të pasqyroj politikën dhe veprimet shfarosëse të shteti serb në Kosovë, që nga pushtimi i pjesës lindore të Kosovës, Luftërat Ballkanike, marrëveshjet Turko Jugosllave e deri tek suprimimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989, si dhe pasojave pas suprimimit të autonomisë, si dhe pasojave të luftës gjatë vitit 1998-1999. Veprime këto të shkaktuara në mënyrë sistematike nga ana e shtetit serb në Kosovë.

Kandidati ka arritur të argumentoj se qëllimi i politikës serbe në Kosovë ishte ndryshimi i strukturës etnike të popullsisë. Një pjesë e popullsisë shqiptare do të vriteshin, pjesa më e madhe do të detyroheshin dhunshëm të largoheshin nga vendbanimet e tyre dhe një pjesë e vogël që do të mbetej, do të asimilohej lehtësisht.

### **Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:**

Tema të cilën e ka punuar kandidati i takon periudhës së afërt prandaj, nuk është trajtuar gjerësisht nga studiuesit deri tani. Ky studim do të shërbej si nxitje në të ardhmen që kjo temë të hulumtohet më gjerësisht nga studiues të tjerë.

Kandidati ka shfrytëzuar burime relevante, të cilat e bëjnë temën të rezistueshme nga kritikrat shkencore. Ai ka bërë krahasim të burimeve të ndryshme, të cilave u është qasur në mënyrë shkencore.

E veçanta e kësaj teme qëndron në faktin se kandidati ka arritur të realizoj intervista me disa nga protagonistët kryesorë të ngjarjeve dhe zhvillimeve, të cilat trajtohen në temë.

**Hulumtime të mundshme në të ardhmen:**

Tema e doktoratës "Gjenocidi në Kosovë gjatë luftës 1998-1999" është e një rëndësi të veçantë, çka jep mundësi që në të ardhmen kandidati ose studiues të tjerë të trajtojnë çështje të veçanta.

Kandidati ka bërë përpjekje për të dhënë pasqyrë sa më të plotë të ngjarjeve, të cilat lidhen me temën. Puna e tij përbën kontribut të çmueshëm jo vetëm për fushën juridike, por edhe në të drejtën ndërkombëtare. Prandaj, tema e tij mund të shërbej si pikënisje për thellimin e hulumtimeve për njërën ndër ngjarjet më të rëndësishme në nivel jo vetëm të brendshëm, por edhe atë ndërkombëtar.

**Vlerësim dhe rekomandim:**

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës "Gjenocidi në Kosovë gjatë luftës 1998-1999", të kandidatit Mr. sc. Artan Tahiri, ka nderin që t'i propozoj Këshillimit mësimor-shkencor të Fakultetit juridik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

**Komisioni:**

1. Prof. Dr. Afrim Osmani (kryetar) \_\_\_\_\_ ;
2. Prof. Dr. Fatbardha Ismaili (anëtar) \_\_\_\_\_ ;
3. Prof. Dr. Afet Mamuti (anëtar) \_\_\_\_\_ ;
4. Prof. Dr. Shefik Shehu, (anëtarë) \_\_\_\_\_ ;
5. Prof. Dr. Qebir Avziu (mentor) \_\_\_\_\_ ;

Tetovë,

02 shtator 2021